



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivry	21.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINISACK	8252/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 982/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 982/2022, të datës 08.11.2022, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numër A.nr. 982/2022 të datës 08.11.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Akt emërimit të datës 21.09.2012, në pozitën "Udhëheqës i Divizionit Ligjor", në Drejtorinë Qendrore, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datën 25.07.2022, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.849, sipas të cilit ankuesin e ka caktuar nga pozita Udhëheqës i Divizionit ligjor "në Drejtorinë Qendrore të SHKK-së në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme "në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, me arsyetimin se pozita e "Udhëheqësit të Divizionit Ligjor" nuk parashihet në Rregulloren QRK.Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.849/2022 të datës 25.07.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 07.09.2022, ka parashtruar

ankesën me numër të protokollit 5203/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.09.2022 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.662/2022 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses së datës 26.07.2022 dhe ka vërtetuar Vendimin me numër protokollit 849 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 25.07.2022.

Ankuesi [redacted] përsëri më datë 08.11.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6886/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 849 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 25.07.2022 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.11.2022, me numër protokollit 7110/2022 ka bënë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa më datë 05.12.2022, Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 982/2022 e datës 08.11.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 6868/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 25.07.2022, me numër protokollit 849, i Z, V Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt Emërimi i datës 22.09.2012; Akt Emërimi i datës 06.12.2017; Vendimi i datës 02.06.2022; Konkursi i Brendshëm; Vendimi i datës 17.05.2022, me numër protokollit 0562/2022; Vendimi i datës 25.07.2022, me numër protokollit 848; Akt Emërimi i datës 25.07.2022; Vendimi A. Nr. 747/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 25.07.2022, me numër protokollit 849, i Z, V Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 05.12.2022, me numër protokollit 7644/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi [redacted] është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Akt emërimit të datës 21.09.2012, në pozitën "Udhëheqës i Divizionit Ligjor", në Drejtorinë Qendrore, ndërsa Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datën 25.07.2022, ka nxjerrë Vendim me numër Nr.849, sipas të cilit ankuesin e ka caktuar nga pozita „Udhëheqës i Divizionit ligjor “në Drejtorinë



Qendrore të SHKK-së në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme "në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, me arsyetimin se pozita e "Udhëheqësit të Divizionit Ligjor" nuk parashihet në Rregulloren QRK.Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.849/2022 të datës 25.07.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 26.07.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4311/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.09.2022 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.662/2022 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 26.07.2022 dhe ka vërtetuar Vendimin me numër protokollit 849 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 25.07.2022.

Ankuesi [redacted] përsëri më datë 08.11.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6886/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 849 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 25.07.2022 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se lidhur me vendimin e kontestuar me ankesë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me datën 19.09.2022 përmes Vendimit me numër A.nr.662/2022, rrjedhimisht Këshilli e refuzuar ankesën e datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] dhe ka lënë në Vendimin me numër protokollit 849 të datës 25.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse lidhur me Vendimin me numër protokollit 849 të datës 25.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të kontestuar me ankesë është vendosur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike*", Kolegji i Këshillit, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesës A.nr. 982/2022 e datës 08.11.2022, sepse është vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën

kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.982/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

